

# MANUAL PËRDORIMI

## Edukimi në Distancë

Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi  
në fëmijërinë e hershme për moshën 0 - 6 vjeç

Prill, 2020



## TABELA E PËRMBAJTJES

1. Pse "Edukimi në Distancë Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0 - 6 vjeç"?	3
2. Partnerët dhe mbështetësit e platformës: "Edukimi në Distancë Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0 - 6 vjeç"?	4
3. Si përdoret platforma?	5
4. Si dërgohet raporti javor nga Edukatorët?	12
5. Cfare përmban Faqja Tema Mujore?	14
6. Pse shërbejn Materialet Mbështetëse në këtë platformë?	15
7. Cfarë forme janë ofruar këshillat se si të flasim me fëmijët për COVID19?	16
8. Si të kontaktoni me ne për pyetje dhe informata të tjera?	17

## 1. Pse "Edukimi në Distançë Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0 - 6 vjeç"?

Kjo platformë vjen për ju me qëllim që të jemi pranë jush në realizimin e aktiviteteve ditore me fëmijët tuaj në kushte shtëpie. Përmbajtja e aktiviteteve të prezantuara në këtë Platformë i stimulon fëmijët në zhvillimin e tyre në të gjitha fushat zhvillimore në varësi të moshës së tyre si në fushën fizike, njohëse, emocionale, matematikore dhe në atë të kreativitetit.

Po ashtu kjo platformë do të sjellë informata se si të flasim me fëmijët për COVID-19, do të ketë tema mujore, formularë monitorimi për edukatorë, shembuj të aktiviteteve të realizuara nga fëmijët, video të ndryshme dhe materiale që flasin për zhvillimin e fëmijëve në moshën e hershme.

Për fëmijët kjo periudhë e vështirë do të bëhet më e lehtë dhe më cilësore. Punoni bashkë me fëmijët tuaj gjatë aktiviteteve ditore të paraqitura në këtë platformë!

Kënaquni bashkë, luani bashkë, mësoni bashkë me fëmijët tuaj - ky është përfitimi më i mirë në këtë kohë të vështirë!

Ju dëshirojmë shëndet të mirë dhe ju rekomandojmë që t'i zbatoni udhëzimet që na japin profesionistët për ta ruajtur shëndetin dhe për ta kaluar kohën së bashku, në mënyrë sa më të mirë. Platforma "Edukimi në Distançë" do të sjellë çdo javë gjëra të reja të cilat do t'u shërbejnë fëmijëve, prindërve/kujdestarëve ligjor dhe edukatorëve. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në bashkëpunim me partnerët dhe me ekspertët, do të jetë e gatshme t'u përgjigjet pyetjeve tuaja të cilat mund t'i parashtroni çdo ditë.

Rrini në shtëpi bashkë me fëmijët sepse vetëm kështu do ta tejkalojmë këtë pandemi në mënyrën më të mirë!

## 2. Partnerët dhe mbështetësit e platformës: “Edukimi në Distançë Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0 - 6 vjeç”?

- Edukimi në Distançë - Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0 - 6 vjeç është mbështetur nga UNICEF dhe Save the Children:



- Shumë foto dhe video në Edukimi në Distançë - Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0 - 6 vjeç janë mbështetur nga QSHHZH - Qendra për Shërbime Humane dhe Zhvillim dhe nga femijet e institucioneve parashkollore dhe femijet gjate realizimit ne familje:




- Platforma Edukimi në Distançë - Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0 - 6 vjeç është dizajnuar dhe zhvilluar nga Open Data Kosovo.



### 3. Si përdoret platforma?

**Hapi 1:** Për tu kyçur në platformën tonë shkruani web adresën: [www.edukimihershem.rks-gov.net](http://www.edukimihershem.rks-gov.net)



**Hapi 2:** Tani jeni në platformë dhe do të ju shfaqet pamja si në vijim. Filloni të eksploroni duke lëvizur me maus në përmbajtjen e saj.



**Hapi 3:** Për të filluar aktivitetin ditor, ju lutem vetëm Klikoni me maus në "Fillo aktivitetin ditor". Ku aty pastaj do të ju shfaqen aktivitetet ditore për moshën 0-3 vjeç dhe moshën 3-6 vjeç. Në këtë mënyrë duhet të veproni çdo ditë, sepse për çdo ditë do të ketë aktivitete të reja ditore për moshat 0-3 vjeç dhe 3-6 vjeç.



**Hapi 4:** Kur jeni në këte faqe pasi keni klikuar **Fillo Aktivitetin Ditor**, ju duhet të përzgjedhni moshën që ka fëmija juaj për të filluar aktivitetin ditor.



**Hapi 5:** Nëse keni fëmijën në grupmoshën **0-3 vjeç**, atëherë do të ju shfaqen aktivitetet ditore të përgaditura për këtë grupmoshë si në pamjen në vijim. Ju duhet te klikoni mbi tutiullin e aktiviteteti dhe menjëherë do të ju hapet përmbajtja. Nëse dëshironi të ktheheni mbrapa, ju lutem vetëm klikoni mbi **Kthehu Mbrapa**.

REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS,  
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

Fillimi Aktivitetet ditore Tema mujore Materiale mbështetëse COVID-19 Kontaktoni Q

Kthehu Mbrapa <

### Aktivitet ditore për moshat 0-3 vjeç



**Ngjesim, çngjesim**  
0-3 vjeç

**Më e madhe, më e vogël**  
0-3 vjeç  
Më e madhe, më e vogël Vendosi mbi tavolinë

**Hapi 6:** Nëse keni fëmijën në grupmoshën **3-6 vjeç**, atëherë do të ju shfaqen aktivitetet ditore të përgaditura për këtë grupmoshë të ndara për moshën **3-4 vjeç**, **4-5 vjeç** dhe **5-6 vjeç** si në pamjen në vijim. Ju duhet të klikoni mbi tutiullin e aktiviteteti dhe menjëherë do të ju hapet përmbajtja. Nëse dëshironi të ktheheni mbrapa, ju lutem vetëm klikoni mbi **Kthehu Mbrapa**.

The screenshot shows a website interface for early childhood education. At the top, there is a navigation menu with links: Fillimi, Aktivitetet ditore, Tema mujore, Materiale mbështetëse, COVID-19, and Kontaktoni. A search icon is also present. Below the menu, there is a blue button labeled "Kthehu Mbrapa <". The main heading is "Aktivitet ditore për grup-moshat 3-6 vjeç". Below this heading, there are three activity cards:

- Mos u rrëzo** (3-4 vjeç): Illustration of three children jumping rope. Description: "Mos u rrëzo Për këtë lojë shumë argëtuese ju".
- Ylberi** (4-5 vjeç): Illustration of a rainbow and a smiling sun. Description: "Ylberi Për aktivitetin e sotëm do t'ju duhet".
- Vizatimi pa e parë** (5-6 vjeç): Illustration of two children painting at an easel. Description: "Vizatimi pa e parë".



**Hapi 7:** Për të hapur dhe filluar aktivitetin, ju lutem vetem klikoni mbi shenjën:



**Ngjesim, çngjesim**

0-3 vjeç

Ngjesim, çngjesim Për këtë lojë nevojiten:  
ngjitës me madhësi dhe



**Hapi 8:** Pasi keni hapur aktivitetin, është koha të filloni të lexoni instruksionet e nevojshme për të filluar dhe realizuar aktivitetin me sukses në bashkëpunim me fëmijen tuaj. Në këtë mënyrë duhet të veproni çdo ditë, sepse për çdo ditë do të ketë aktivitete të reja ditore.

REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS,  
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

Fillimi Aktivitetet ditore Tema mujore Materiale mbështetëse COVID-19 Kontaktoni Q



### Ngjesim, çngjesim

Për këtë lojë nevojiten: ngjitës me madhësi dhe ngjyra të ndryshme, objekte apo lodra të ndryshme.

- Së bashku me fëmijët ngjisni në dysheme, në tavolinë, në dollap ose në mur ngjitës me ngjyra të ndryshme dhe me madhësi të ndryshme,
- Ju mund të krijoni figura të ndryshme me ngjitës, si figura të kafshëve të formave të ndryshme gjeometrike, forma të objekteve etj., apo edhe të ngjisni lodra të fëmijëve ose objekte tjera ricikluese,
- Fëmijët duhet të angazhohen për ngjitjen e tyre,
- Pastaj ju duhet të thoni emrin e objektit apo formën që e keni ngjitur së bashku. Fëmija e gjen se cili objekt është dhe duhet ta çngjisë,
- Vazhdoni kështu për të gjitha figurat, format apo objektet e ngjitura,

Loja zhvillon motorikën fine dhe koordinimin dhe prezanton fëmijët me konceptet gjeometrike, me format, me ngjyrat dhe me madhësitë.

< Aktiviteti kaluar Aktiviteti tjetër >

**Date**  
2020-04-30

**Category**  
0-3 vjeç

**Share**  
f t in @

#### 4. Si dërgohet raporti javor nga Edukatorët?

Ky raport plotësohet nga edukatorët e grupit për të dëshmuar bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre për prindërit gjatë realizimit të aktiviteteve ditore/javore, në kushte shtëpie të paraqitura në platformën Edukimi në Distançë-Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme 0-6 vjeç. Në këtë raport, do të kenë qasje vetëm menaxherët e edukatorëve, në rastin e institucionit parashkollor do të jetë drejtori i institucionit parashkollor, ndërsa në rastin e klasës para-filllore drejtori i shkollës. Ky raport nuk është publik.

Në faqen e njejtë ku i vizituat aktivitetet ditore, ndodhen dy (2) opsionet për të dërguar **Raportin Javor nga Edukatorët**.

**OPSIONI 1: Klikoni këtu për të shkarkuar formën klasike të Raportit Javor**

**OPSIONI 2: Klikoni këtu për të plotësuar formën digjitale të Raportit Javor.**

##### Raporti javor nga edukatorët

(Ky raport plotësohet nga edukatorët e grupit për të dëshmuar bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre për prindërit gjatë realizimit të aktiviteteve ditore/javore, në kushte shtëpie të paraqitura në platformën Edukimi në Distançë-Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme 0-6 vjeç. Në këtë raport, do të kenë qasje vetëm menaxherët e edukatorëve, në rastin e institucionit parashkollor do të jetë drejtori i institucionit parashkollor, ndërsa në rastin e klasës para-filllore drejtori i shkollës. Ky raport nuk është publik.)

 [Klikoni këtu për të shkarkuar formën klasike të Raportit Javor.](#)

 [Klikoni këtu për të plotësuar formën digjitale të Raportit Javor.](#)


## OPSIONI 1: Klikoni këtu për të shkarkuar formën klasike të Raportit Javor.

**Hapi 1:** Klikoni në butonin si në pamjen më poshtë për të shkarkuar dokumentin zyrtar të raportimit për të dëshmuar bashkëpunimin dhe mbështetjen tuaj për prindërit gjatë realizimit të aktiviteteve ditore/javore, në kushte shtëpie të paraqitura në platformë.



Klikoni këtu për të shkarkuar formën e raportit.

**Hapi 2:** Pasi të keni shkarkuar dokumentin, plotësoni të dhënat dhe bashkëngjiteni ne emailin tuaj dhe dërgojeni përmes email tek Menaxheri ku ju punoni.



RAPORTI JAVOR NGA EDUKATORËT  
(Bashkëpunimi prind-edukatorë)

(Ky raport plotësohet nga edukatorët e grupit për të treguar bashkëpunimin dhe mbështjen e tyre për prindërit gjatë realizimit të aktiviteteve ditore/javore, realizuar në kushte shtëpie të paraqitura në Platformën Edukimi në Distançë-Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç. Në këtë raport, do të kenë çasje vetëm menaxherët e edukatorëve, në rastin e institucionit parashkollor drejtori i institucionit parashkollor, në rastin e klasës para-fillore drejtori i shkollës. Ky raport nuk është publik.)

1. Periudha raportimit:	
-------------------------	--

## OPSIONI 2: Klikoni këtu për të plotësuar formën digjitale të Raportit Javor.

**Hapi 1:** Klikoni në butonin si në pamjen më poshtë për të plotësuar formën digjitale të raportimit për të dëshmuar bashkëpunimin dhe mbështetjen tuaj për prindërit gjatë realizimit të aktiviteteve ditore/javore, në kushte shtëpie të paraqitura në platformë.

 [Klikoni këtu për të plotësuar formën digjitale të Raportit Javor.](#)

**Hapi 2:** Pasi të keni klikuar në opsionin e dytë, plotësoni të dhënat dhe dërgojeni përmes kësaj forme raportin javor tek Menaxheri ku ju punoni.



**Forma digjitale e Raportit Javor për Edukatorët**

Ky raport plotësohet nga edukatorët e grupit për të treguar bashkëpunimin dhe mbështjen e tyre për prindërit gjatë realizimit të aktiviteteve ditore/javore, realizuar në kushte shtëpie të paraqitura në Platformën Edukimi në Distançë-Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç.

Në këtë raport, do të kenë çasje vetëm menaxherët e edukatorëve, në rastin e institucionit parashkollor drejtori i institucionit parashkollor, në rastin e klasës para-fillore drejtori i shkollës. Ky raport nuk është publik.

The name and photo associated with your Google account will be recorded when you upload files and submit this form. Not [edukimihershem.rks@gmail.com](mailto:edukimihershem.rks@gmail.com)? [Switch account](#)

\* Required

Email address \*

Your email

1. Periudha raportimit prej? \*

Ju lutem përzgjedhni periudhën prej kur keni filluar raportimin?

Date

## 5. Cfare përmban Faqja Tema Mujore?

Kjo faqe përmban planin mujor, të ndarë në tema javore ku ju mund të shihni aktivitetin ditor të përfunduar (me ngjyrë të gjelbërt) dhe planifikuar (me ngjyrë të zezë). Nëse klikoni me maus mbi një tërësi prej aktiviteteve të përfunduara (me ngjyrë të gjelbërt), atëherë ju mund të hapni direkt atë aktivitetet specifik.

 <span style="float: right;"> <a href="#">Fillimi</a> <a href="#">Aktivitetet ditore</a> <a href="#">Tema mujore</a> <a href="#">Materiale mbështetëse</a> <a href="#">COVID-19</a> <a href="#">Kontaktimi</a> <a href="#">Q</a> </span>					
<b>20-24 Prill - TEMA JAVORE: DITA E TOKËS</b>					
Mosha e fëmijëve	E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE
0 - 3 vjeç	<input checked="" type="checkbox"/> Kalon... nuk kalon	<input checked="" type="checkbox"/> Kështjella prej letre	<input checked="" type="checkbox"/> Festojmë ditën e tokës	<input checked="" type="checkbox"/> Dashuria për tregimin	<input checked="" type="checkbox"/> Kapërcejmë pengesat
3 - 4 vjeç	<input checked="" type="checkbox"/> Labirinti	<input checked="" type="checkbox"/> Shkojmë në piknik	<input checked="" type="checkbox"/> Festojmë ditën e tokës	<input checked="" type="checkbox"/> Emitojmë kafshët	<input checked="" type="checkbox"/> Qëllojmë në shenjë
4 - 5 vjeç	<input checked="" type="checkbox"/> Patatja e nxehtë	<input checked="" type="checkbox"/> Personazhi im i preferuar	<input checked="" type="checkbox"/> Festojmë ditën e tokës	<input checked="" type="checkbox"/> Loja me enigma (puzzles)	<input checked="" type="checkbox"/> Kërcejmë mbi forma
5 - 6 vjeç	<input checked="" type="checkbox"/> Historia ime	<input checked="" type="checkbox"/> Termomenti i emocioneve	<input checked="" type="checkbox"/> Festojmë ditën e tokës	<input checked="" type="checkbox"/> Luajmë me top	<input checked="" type="checkbox"/> Dita e gjëgjëzave
<b>27-30 Prill - TEMA JAVORE: LUAJMË SË BASHKU</b>					
Mosha e fëmijëve	E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE
0 - 3 vjeç	<input checked="" type="checkbox"/> Eksplorojmë me shqisa	<input checked="" type="checkbox"/> Më e madhe, më e vogël	<input checked="" type="checkbox"/> Unë jam piktor	Ngjesim, çngjesim	Festa e 1 Majit
3 - 4 vjeç	<input checked="" type="checkbox"/> Akvariumi	<input checked="" type="checkbox"/> Gjejmë të njejtat	<input checked="" type="checkbox"/> Rrjeta e merimangës	Mos u rrëzo	Festa e 1 Majit
4 - 5 vjeç	<input checked="" type="checkbox"/> Libri i familjes	<input checked="" type="checkbox"/> Vazot me ngjyra	<input checked="" type="checkbox"/> Qëndisim letrën	Ylberi	Festa e 1 Majit
5 - 6 vjeç	<input checked="" type="checkbox"/> E gjeta	<input checked="" type="checkbox"/> Buqetë lulesh	<input checked="" type="checkbox"/> Eksperimenti	Vizatimi pa e parë	Festa e 1 Maji

## 6. Pse shërbejnë Materialet Mbështetëse në këtë platformë?

**Hapi 1:** Ju lutem klikoni fillimisht mbi menun kryesore Materiale Mbështetëse, që ndodhet si e katërta (4) në radhitjen e shiritit horizontal.

**Hapi 2:** Për më shumë informacione rreth zhvillimit të fëmijëve, ju mund të klikoni tek Materialet Mbështetëse dhe aty do të keni fotografi të fëmijëve të realizuar në kushte shtëpie, dokumente të ndryshme të cilat i dedikohen zhvillimit të fëmijëve në aspekte të ndryshme zhvillimore në moshën e hershme, pra moshën 0-6 vjeç.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS,  
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

Fillimi Aktivitetet ditore Tema mujore **Materiale mbështetëse** COVID-19 Kontaktimi Q

## Materiale mbështetëse

Në këtë faqe së shpejti do të jenë të disponueshme edhe dokumente, video dhe materiale të tjera lidhur me zhvillimin e fëmijëve në moshën e hershme, këshilla për mirëqenien psikologjike të prindërve etj.

- Fotografi të fëmijëve të realizuara në kushte shtëpie.
- 1. Fëmijëria e hershme – Thesar për tërë jetën
- 2. Udhëzues praktik për prindër
- 3. Shtatzënësia
- 4. I posalinduri nga lindja deri 1 muaj
- 5. Foshnja me moshë 1-6 muaj

## 7. Cfarë forme janë ofruar këshillat se si të flasim me fëmijët për COVID19?

**Hapi 1:** Ju lutem klikoni fillimisht mbi menyn **COVID-19**, që ndodhet e parafundit në radhitjen e shiritit horizontal.

**Hapi 2:** Organizatat partnere dhe mbështetëse UNICEF dhe Save the Children të platformës "Edukimi në Distançë Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0 - 6 vjeç", vazhdimisht sjellin materiale të ndryshme për të ju ofruar këshilla në lidhje me pandeminë të shkaktuar nga virusi COVID-19.

The screenshot shows a website interface with a navigation bar at the top containing links for 'Fillimi', 'Aktivitetet ditore', 'Tema mujore', 'Materiale mbështetëse', 'COVID-19', and 'Kontaktimi'. The main heading is 'Këshilla të përgjithshme, si të flasim me fëmijët për COVID-19!'. Below the heading is a paragraph of text: 'Derisa shtohet numri i familjeve që përballen me distancimin shoqëror, vetë-karantinën, dhe mbylljen e shkollës dhe punës si rezultat i COVID-19, është e mundur të ndjeheni të stresuar – jo vetëm në lidhje me çështjet shëndetësore, por edhe me realitetin e papritur të të qenit të izoluar në shtëpi për shumë ditë me të vegjlit tuaj energjik.' Below this text is a blue button with a book icon and the text 'Si të flasim me fëmijët rreth Koronavirusit?'. Underneath the button are four content cards, each with a 'Save the Children' logo. The first card is titled 'Menjanoni informatat e tepërta' and features an illustration of a family sitting on a sofa. The second card is titled 'Qëndroni aktiv' and features an illustration of three children jumping joyfully. The third card is titled 'Merrni frymë thellë' and the fourth is titled 'Jepni informata të'.



## 8. Si të kontaktoni me ne për pyetje dhe informata të tjera?

**Hapi 1:** Ju lutem klikoni fillimisht mbi menyn **Kontakttoni**, që ndodhet në fund të radhitjes së shiritit horizontal.

**Hapi 2:** Përpara se të dërgoni pyetjet tuaja në lidhje me platformën sigurohuni që keni lexuar hapësirën e përgjigjeve të pyetjeve më të shpeshta si në pamjen në vazhdim. Ju lutem, klikoni mbi pyetjen për të parë përgjigjen e dhënë nga eksperti për kujdes, zhvillim dhe edukim në fëmijërinë e hershme.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS,  
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

Fillimi Aktivitetet ditore Tema mujore Materiale mbështetëse COVID-19 Kontakttoni Q



**Pyetjet më të shpeshta nga përdoruesit!**


Ju lutem, klikoni mbi pyetjen për të parë përgjigjen e dhënë nga eksperti për kujdes, zhvillim dhe edukim në fëmijërinë e hershme.

1. Si përdoret kjo platformë?
2. Në cilën kohë saktë transmetohet programi?
3. Sa duhet të përfshihem unë si prind në aktivitetin e fëmijës?
4. Çka nëse fëmija nuk dëshiron ta zhvillojë aktivitetin, apo refuzon ta bëjë siç është paraparë në aktivitetin e dërguar?
5. Si duhet të komunikoj me edukatoret?

**Hapi 3:** Nëse asnjëra nga përgjigjet nuk është ajo cfarë ju po kërkonti, atëherë ju lutem përdorni formën që ndodhet pak më poshtë "Kontaktimi për pyetje shtesë" për të drejtuar pyetjen tuaj.

Vendosni pyetjen tuaj në pjesën **Mesazhi juaj** dhe klikoni me maus butonin **Dërgo**.

Keni parasysh që të gjitha pyetjet që i drejtoni janë anonime dhe pas rishikimit nga ekspertët ato pastaj vendosen si përgjigje në pjesën e **Pyetjeve më të shpeshta**.



**Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit**

MASHTI, në bashkëpunim me partnerët dhe ekspertët, do të jetë e gatshme t'u përgjigjet pyetjeve tuaja, të cilat mund t'i dërgoni çdo ditë.

**Adresa**  
Rruga: Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

**Kontaktimi për pyetje shtesë:**

Mesazhi Juaj

Dërgo



## Edukimi në Distancë | Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0 - 6 vjeç

Kyçuni nga pajisjet e juaja: Telefon, Lloptop, apo Tablet

[www.edukimihershem.rks-gov.net](http://www.edukimihershem.rks-gov.net)

Prill, 2020